

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.01.02.2022*

01.02.2022  
Ora 16:35

**RENDI I DITËS**

**Projektakti “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2022”.**

**PJESËMARRJA :**


- **KQZ**
  - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      Z. Ilirjan Celibashi
  - 2. Stafi KQZ:    Y. Merkaj, V. Ballgjini
- **Parti Politike:**    PD (Z. M. Logu)
- **OJQ:**    KRIK

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë në seancën e sotme në rendin e ditës kemi dy projektvendime për të shqyrtuar.

“Projektvendimi “Për shpërndarjen e fondeve vjetore të partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore, për vitin 2022” dhe projektvendimi i dytë ka të bëjë me “Caktimin e ZAZ-së nr. 26, në Bashkinë Vorë, Qarku Tiranë për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave për zgjedhjet e pjesshme vendore, për kryetar të bashkisë, të datës 06 Mars 2022”.

Mirë, do të vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, pikën e dytë do ta shtyjmë ndoshta për nesër ose pasnesër, pasi ta finalizojmë procesin e konsultimit me të gjithë faktorët politikë dhe jo të tillë. Mirë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Po, Sekretari për të relatuar projektaktin.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.01.02.2022*


**Z. Y. Merkaj:** Neni 15/2, pika 2, shkronja “e” e Ligjit “Për partitë politike” përcakton masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore. Neni 19, pika 2 e Ligjit “Për partitë politike” parashikon rregullat e shpërndarjes së fondit si ndihmë financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike. 70% e numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare, çdo parti parlamentare përfiton ndihmë financiare në përputhje me numrin e deputetëve që ka fituar në bazë të sistemit zgjedhor të parashikuar në Kodin Zgjedhor. 20% në mënyrë të barabartë ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë fituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe 10% e fondit sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe që kanë fituar mbi 1% të votave në shkallë vendi. Pjesa që mbetet të shpërndahet nga 10-përqindëshi, i shtohet fondit prej 70% dhe u ndahet partive parlamentare. Ligji nr.115 i vitit 2021, “Për buxhetin e vitit 2022” ka parashikuar fondin prej 345 milionë e 600 mijë lekë si mbështetje financiare për partitë politike për vitin kalendarik 2022. Objekti i projektvendimit është për të përcaktuar në mënyrë të llogaritjes dhe kriteret për shpërndarjen e fondit vjetor, si ndihmë financiare e partive politike, si dhe përcaktimin e partive politike që u lind e drejta të fitojnë fond, këtë fond vjetor. Projektvendimi cakton qartë të gjitha partitë politike që u lind e drejta të fitojnë fondin vjetor duke iu referuar rezultatit të fundit të zgjedhjeve parlamentare. Mënyra e llogaritjes është bërë si më poshtë vijon:

Për llogaritjen e 70% të vlerës prej 345 milionë e 600 mijë nga buxheti i shtetit, 70% e kësaj vlere i takon 241 milionë e 920, e cila pjesëtohet me numrin 140 të deputetëve dhe rezultati që del nga ky pjesëtim, shumëzohet për numrin e mandateve që ka fituar çdo parti politike.

Rezultati është 1 milion e 728 mijë dhe duke bërë llogaritjet:

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Dt.01.02.2022*

Partia Socialiste, e cila ka fituar 74 mandate përfiton 127 milionë e 872 mijë lekë;

Partia Demokratike ka fituar 49 mandate dhe përfiton 84 milionë e 672 mijë lekë;

Partia Drejtësi Integrим dhe Unitet ka fituar 2 mandate dhe fiton 3 milionë e 456 mijë lekë;

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia Agrare Ambientaliste, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Partia Lëvizja e Legalitetit, të cilat kanë fituar nga 1 mandat, përfitojnë 1 milion e 728 mijë lekë.


Partia Republikane dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrим, të cilat kanë fituar nga 4 mandate përfitojnë 6 milionë e 912 mijë lekë.

Partia Socialdemokrate, e cila ka përfituar 3 mandate, përfiton 5 milionë e 184 mijë lekë.

Po kështu sipas pikës “b”, të nenit 19, të ligjit për partitë politike, llogaritet dhe 20% e shumës totale të përcaktuar, e cila përkon me 69 milionë e 120 mijë, e cila pasi pjesëtohet me numrin e partive që kanë fituar mbi 10 mijë vota, del rezultati se të gjitha partitë: Partia Socialiste, Partia Demokratike, Partia për Drejtësi Integrим dhe Unitet, Partia Republikane Shqiptare, Partia Agrare Ambientaliste, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia Lëvizja Socialiste për Integrим, Partia Socialdemokrate dhe Partia Nisma Thurje përfitojnë të gjitha në mënyrë të barabartë nga 6 milionë e 283 mijë e 636 mijë lekë. Sipas pikës “ë” të nenit 19, të ligjit për partitë politike është llogaritur dhe shuma 10% e vlerës totale prej 345 milionë e 600 mijë dhe nga llogaritja del rezultati se Partia Socialiste ka përfituar 16 milionë e 820 mijë e 352 mijë lekë. Partia Lëvizja Socialiste për Integrим ka fituar 6.81% dhe përfiton 2 milionë e 333 mijë e 536 lekë. Partia Socialdemokrate, e cila ka fituar 2.25%, përfiton 777 mijë e 600 lekë. Koalicioni Partia Demokratike -Aleanca për Ndryshim, e cila ka përfituar 39.43%, i takon 113 milionë e 627 mijë lekë. Referuar nenit 65, pika 3 të Kodit Zgjedhor për të sanksionuar momentin e

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.01.02.2022*

regjistrimit të koalicionit, duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit dhe marrëdhënien midis partive politike të koalicionit si dhe detyrimet, rregullojnë marrëveshjen midis këtyre partive. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ky ligj përbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Pjesa e cila mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi, ju shtohet partive politike që janë pjesëmarrëse në zgjedhje dhe në parlament dhe nga shuma totale që përfiton secila...

Përfundimisht secila parti si mbështetje financiare për vitin 2022 përfiton:

Partia Socialiste që përfiton 151 milionë 494 mijë e 783 lekë.

Partia Demokratike përfiton 104 milionë e 926 mijë e 170 lekë.

Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet përfiton 8 milionë e 18 mijë e 647 lekë.

Partia Republikane përfiton 13 milionë e 223 mijë e 679 mijë lekë.

Partia Agrare Ambientaliste përfiton 8 milionë e 18 mijë e 647 lekë, po kështu dhe

Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar dhe Partia Lëvizja e Legalitetit.

Partia Lëvizja Socialiste për Integrim përfiton 15 milionë e 577 mijë e 215 lekë.

Partia Socialdemokrate përfiton 12 milionë e 266 mijë e 268 lekë.

Partia Nisma Thurje përfiton 6 milionë e 283 mijë e 636 lekë.

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

---

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike në lidhje me projektaktin, në parim, besoj jemi dakord?

---

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Celibashi! Jemi njojur me projektaktin të dërguar në formë elektronike nga administrata e KQZ-së. Nuk kemi asnje objeksion. Jemi dakord në parim dhe nen për nen, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.01.02.2022*

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Atëherë meqenëse nuk kemi asnjë propozim apo diskutim në lidhje me përbajtjen e këtij projektakti, po e miratojmë sipas draftit të propozuar, sipas të cilit kemi. Atëherë,

Partia Socialiste e Shqipërisë përfiton fondin 151 milionë e 494 mijë e 783 lekë.

Partia Demokratike 104 milionë e 926 mijë e 170 lekë.

Partia për Drejtësi Integrим dhe Unitet 9.753.657 lekë.

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, 8 milionë e 18 mijë e 647 lekë.

Partia Republikane, 13 milionë e 223 mijë e 679 lekë.

Partia Agrare Ambientaliste, 8 milionë e 18 mijë e 647 lekë.

Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, 8 milionë e 18 mijë e 647 lekë.

Partia Lëvizja e Legalitetit, 8 milionë e 18 mijë e 647 lekë.

Partia Lëvizja Socialiste për Integrим, 15 milionë e 577 mijë e 215 lekë.

Partia Socialdemokrate, 12 milionë 266 mijë e 269 lekë.

Partia Nisma Thurje, 6 milionë e 283 mijë e 636 lekë.

Në total fondi i shpërndarë është 345 milionë e 600 mijë lekë.

Mirë faleminderit, seanca mbyllt!

**Vendimi nr. 31**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

